Estonia

ÇFARË DUHET TË DINI RRETH ZHVENDOSJES

KËRKUESIT E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Shënim. **Kjo broshurë përmban informacione që janë të rëndësishme për ju. Nëse keni paqartësi, mund t'i kërkoni një nëpunësi që t'ju sqarojë.**

ALBANIAN

PËRMBAJTJA

Çfarë është zhvendosja? 3

Nëse jeni zgjedhur, në cilin vend do të zhvendoseni? 4

Çfarë pritet nga ju nëse jeni zgjedhur për zhvendosje? 5

Çfarë ndodh nëse nuk bashkëpunoni me autoritetet? 5

Çfarë ndodh nëse keni me vete anëtarë të familjes? 6

A do të kryhet intervistë përpara zhvendosjes? 6

Si të veproni nëse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit? 7

- Ankimimet e ndara me efekt pezullues dhe ato në themel 8

Sa kohë merr procesi i zhvendosjes? 9

Çfarë do të ndodhë pas zhvendosjes? 10

ÇFARË ËSHTË ZHVENDOSJA?

Vendet e Bashkimit Evropian dhe 4 vende të tjera kanë miratuar një ligj të përbashkët të quajtur Rregullorja për Menaxhimin e Azilit dhe Migracionit (AMMR). Ky ligj ndihmon në përcaktimin e vendit përgjegjës për shqyrtimin e një kërkese për mbrojtje ndërkombëtare. Këto vende njihen si vendet e BE+.

Vendet e tjera mund të mbështesin në mënyra të ndryshme një vend i cili merr njëkohësisht shumë kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare dhe e ka të pamundur t'i trajtojë ato. Disa prej kërkuesve mund të transferohen në një vend tjetër. Kjo quhet zhvendosje.

Në një situatë të tillë, kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare mund të mos shqyrtohet në këtë vend. Aktualisht, në zhvendosjet drejt vendeve të tjera mund të marrin pjesë vetëm 26 vende të BE+.

E RËNDËSISHME! Aktualisht ndodheni në [Estonia], i cili është një vend i BE+.

26 vendet e BE+ që mund të marrin pjesë aktualisht në zhvendosje janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Çekia, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Republika e Irlandës, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Suedia.

5 vendet e "asociuara" dhe vendet e tjera që nuk marrin pjesë aktualisht në zhvendosje janë: Danimarka, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

NËSE ZGJIDHENI, NË CILIN VEND DO TË ZHVENDOSENI?

Autoritetet do të vendosin se cilët persona mund të zhvendosen.

Fillimisht, ato do të kontrollojnë nëse keni **lidhje të forta** me një vend tjetër. Këto lidhje mund të bazohen te:

- aspektet familjare (anëtarët e rrethit të ngushtë familjar, por edhe rrethi më i gjerë familjar, si p.sh. kushërinjtë)
- aspektet kulturore (si p.sh., fakti nëse flisni gjuhën e atij vendi)

E RËNDËSISHME! Ju nuk mund të zgjidhni vendin në të cilin do të zhvendoseni.

Nëse keni dokumente që provojnë lidhjen tuaj me një vend tjetër, ju duhet t'i dërgoni ato menjëherë tek autoritetet. Në të kundërt, autoritetet nuk do të mund të marrin në konsideratë lidhjen tuaj me atë vend.

Megjithatë, kjo nuk garanton që ju do të zhvendoseni në atë vend.

Nëse nuk keni lidhje të forta me një vend tjetër, ju do të zhvendoseni në një vend që do të zgjidhet nga vendet pjesëmarrëse në zhvendosje.

Nëse keni prova që tregojnë se keni lidhje të forta me një vend tjetër, ju duhet t'i dërgoni ato duke përdorur informacionin e mëposhtëm.

asylym.list@politsei.ee.

ÇFARË PRITET NGA JU NËSE JENI ZGJEDHUR PËR ZHVENDOSJE?

Nëse jeni zgjedhur për zhvendosje, ju keni detyrimin:

- të bashkëpunoni me autoritetet dhe të ndiqni udhëzimet e tyre
- të qëndroni në këtë vend deri në datën e udhëtimit dhe të mbeteni në kontakt me autoritetet
- të qëndroni në vendin e zhvendosjes derisa të shqyrtohet kërkesa juaj.

ÇFARË NDODH NËSE NUK BASHKËPUNONI ME AUTORITETET?

E RËNDËSISHME! Nëse refuzoni të bashkëpunoni me autoritetet, ju do të përballeni me pasoja negative.

Nëse udhëtoni drejt një vendi tjetër pa lejen e autoriteteve ose nëse lëvizni nga vendi i zhvendosjes, ju do të humbisni disa të drejta të caktuara që keni si kërkues. Për shembull:

- **nuk do të përfitoni më shumë shërbime dhe shumë lloje mbështetjeje**
- **nuk do t'ju lejohet të punoni** apo të ndiqni kurse.

ÇFARË NDODH NËSE KENI ME VETE ANËTARË TË FAMILJES?

Nëse aktualisht jeni i shoqëruar nga anëtarë të rrethit të ngushtë familjar dhe jeni zgjedhur për zhvendosje, atëherë familja juaj do të zhvendoset së bashku me ju.

Do të konsiderohen anëtarë të rrethit të ngushtë familjar:

- bashkëshorti ose bashkëshortja juaj
- partneri/ja i/e pamartuar me të cilin/ën keni një marrëdhënie të qëndrueshme



- fëmija juaj (nën 18 vjeç dhe i pamartuar).

A DO TË KRYHET INTERVISTË PËRPARA ZHVENDOSJES?

Do të organizohet një intervistë në rast se na nevojitet më shumë informacion nga ana juaj. Intervista do të përqendrohet rreth aspekteve të sigurisë. Autoritetet do t'ju japin paraprakisht detaje në rast se duhet të merrni pjesë në një intervistë të tillë.

SI TË VEPRONI NËSE NUK JENI DAKORD ME VENDIMIN E TRANSFERIMIT?

Nëse pranoheni për zhvendosje, do të merrni **vendimin e transferimit** , i cili parashikon vendin në të cilin do të zhvendoseni.

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit, mund t'ia paraqisni gjykatës arsyet përkatëse. Kjo procedurë quhet depozitimi i ankimimit. Kur ju ankimoni një vendim, gjykata ose tribunali do të marrë një vendim përfundimtar.

Nëse është e nevojshme, për ankimimin mund t'ju ndihmojnë një këshilltar ligjor dhe një përkthyes, pa pagesë.

Ka vetëm tri arsye për ankimimin e një vendimi për zhvendosje:

- ju pretendoni se transferimi në atë vend do të binte ndesh me të drejtat e njeriut
- ka informacione të reja që nuk ishin të disponueshme në momentin e vendimit të transferimit, të cilat mund të ndikonin te ky i fundit
- ju keni familjarë në një vend tjetër me të cilët duhet të bashkoheni

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit që parashikon zhvendosjen tuaj në një vend tjetër, ju duhet ta ankimoni këtë vendim në adresën e mëposhtme të email-it: talhk.menetlus@kohus.ee.

Në vendimin e transferimit që do të merrni shpjegohet afati, vendi dhe mënyra e depozitimit të ankimimit.

Fillimisht, do t'ju kërkohet të shpjegoni arsyen ose arsyet se përse duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend ndërsa ankimimi juaj është në pritje. Një gjë e tillë njihet si ankimimi me efekt pezullues.

Gjykata do të vendosë brenda **1 muaji** nëse duhet t'ju lejohet qëndrimi në këtë vend ndërsa ankimimi juaj është në pritje.

Nëse gjykata vendos që ju nuk duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend ndërsa merret vendimi për ankimimin tuaj, atëherë ju do të transferoheni në vendin e zhvendosjes ndërsa ankimimi juaj është në pritje të vendimit.

Nëse gjykata vendos që ju duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend ndërsa merret vendimi për ankimimin tuaj, atëherë do t'ju kërkohet të shpjegoni arsyen ose arsyet se përse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit. Më pas, gjykata do të përpiqet t'jua japë vendimin brenda **1 muaji** nga data e vendimit të ankimimit me efekt pezullues.

Nëse ankimimi juaj refuzohet, ju do të transferoheni në vendin e zhvendosjes. Transferimi duhet të kryhet jo më vonë se 4 javë nga data e vendimit përfundimtar të gjykatës.

E RËNDËSISHME! Ju duhet të bashkëpunoni me autoritetet dhe të udhëtoni drejt vendit të zhvendosjes.

SA KOHË MERR PROCESI I ZHVENDOSJES?



Nëse nuk e ankimoni vendimin, transferimi duhet të kryhet brenda 4 javëve pasi vendi i zhvendosjes i BE+ të konfirmojë kërkesën.

Nëse gjykata vendos se nuk ka arsye që ju të qëndroni në këtë vend ndërsa ankimimi juaj është në pritje, ju do të transferoheni drejt vendit të zhvendosjes ndërsa ankimimi juaj është në pritje

Nëse ankimoni vendimin e transferimit dhe gjykata vendos që ju duhet të lejoheni të qëndroni në këtë vend ndërsa ankimimi juaj është në pritje, transferimi duhet të kryhet brenda 4 javëve nga data e vendimit të ankimimit, në rast se ankimimi refuzohet. Do të informoheni të paktën 2 ditë përpara datës së zhvendosjes. Nëse ankimimi juaj pranohet, ju nuk do të zhvendoseni dhe do të qëndroni në këtë vend.

Nëse gjykata vendos se nuk ka arsye që ju të qëndroni në këtë vend ndërsa ankimimi juaj është në pritje, ju do të transferoheni drejt vendit të zhvendosjes ndërsa ankimimi juaj është në pritje.

ÇFARË DO TË NDODHË PAS ZHVENDOSJES?

Si rregull, kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare do të shqyrtohet nga vendi i zhvendosjes. Nëse pas zhvendosjes suaj zbulohet se ju keni një anëtar të familjes në një vend tjetër, ju mund të transferoheni në atë vend për të shqyrtuar kërkesën tuaj.

Kjo broshurë shërben vetëm për qëllime informuese. Ajo nuk krijon në vetvete të drejta apo detyrime. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) ka siguruar strukturën kryesore të këtij materiali dhe riprodhimi dhe ndryshimi i kësaj broshure autorizohet nga EUAA-ja vetëm për shtetet anëtare të BE-së. EUAA-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi apo detyrim për saktësinë, përmbajtjen, plotësinë, ligjshmërinë ose besueshmërinë e informacionit të përfshirë në këtë broshurë nga shtetet anëtare të BE-së ose nga ndonjë palë tjetër e tretë përgjegjëse. EUAA-ja dhe çdokush që vepron në emër të EUAA-së nuk mbajnë përgjegjësi për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve që përmban kjo broshurë.

© Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin, 2025